



Partia
Demokratike



LIBRI

I PUNËVE TË MIRA TË PARTISË DEMOKRATIKE

Udhërrëfyes për demokratët
dhe qytetarët shqiptarë

PËRMBLEDHJE

FRYMËZIMI

Pa kujtesë, nuk ka identitet
Pa identitet, nuk ka forcë
Pa forcë, nuk mund të luftohet e keqja.

Dashmirësit e **Partisë Demokratike** duhet të jenë krenarë për historinë e tyre, kjo krenari u përcjell atyre dhe më pas qytetarëve shqiptarë, forcën, besimin e shpresën për një të ardhme më të mirë.

Pasuria më e madhe e **Partisë Demokratike** janë zemrat e njerëzve që e përbëjnë. Vetëm bashkimi i tyre rreth së shkuarës dhe së sotmes, mund të prodhojë të nesërmen që ëndërrojmë.

METODOLOGJIA

Ky dokument është përgatitur duke u mbështetur në një nga parimet themelore të Departamentit Brain Gain që është **Lidhja midis brezave**. Për një kohë shumë të gjatë është krijuar një përplasje artificiale midis brezave në Partinë Demokratike. Kjo kohë duhet kuptuar dhe kjo përplasje duhet luftuar.

Anëtarët e Departamentit Brain Gain, studentë ose ish studentë ekselentë shqiptarë nëpër botë, kanë **bashkëpunuar ngushtë me personalitete** që kanë ushtruar përgjegjësi të larta politike gjatë qeverisjeve të PD ndër vite dhe që i janë përgjigjur f tesës së tyre.

Ky bilanc paraqitet me një gjuhë të thjeshtëzuar dhe nuk mëton aspak të jetë shterrues lidhur me arritjet e Partisë Demokratike në përmbushje të përgjegjësisë së saj politike dhe morale ndaj Shqipërisë dhe kombit.

Ai vjen si një **gur që i mungon sot shtëpisë sonë të përbashkët** dhe trajton vetëm çështje të përzgjedhura të cilat autorët gjykojnë më të spikatura

SHËNIM

PËR LEXUESIN

Zëri i arsyes depërton vështirë në një shoqëri të sunduar nga propaganda dhe patronazhistët.

Këto të fundit tentojnë të imponojnë një narrative fajësuese, përrulëse dhe thellësisht kontradiktore ku në njërën kah thuhet se demokratët nuk kanë bërë asgjë dhe në tjetrin pritet nga po këta demokratë që të kërkojnë vazhdimisht falje se çdo e keqe ka ardhur prej tyre.

Është thelbësore që demokratët dhe qytetarët shqiptarë të dalin nga ky qark i mbyllur. Për këtë duhet të mbështetemi në fakte qarta dhe mbi një logjikë të thjeshtë.

Një bilanc duhet vlerësuar kryesisht në dy mënyra:

1. Vlerësimi përballë vetes

Duhet ditur nëse të mirat që ka sjellë Partia Demokratike janë më të shumta se problemet apo dështimet që ka njohur.

2. Vlerësimi përballë kundërshtarit

Duhet ditur nëse të mirat që ka sjellë Partia Demokratike janë më të shumta se të mirat e sjellura nga kundërshtarët politikë.

Përgjigja e këtyre pyetjeve mbështetur mbi fakte larg pasionit të komunikimit politik është PO!

100 herë PO!

DATA

KYÇE

8 DHJETOR

1990

Protestat studentore

11 DHJETOR

1990

Krijimi i Partisë Demokratike

31 MARS

1991

Zgjedhjet e para pluraliste

22 MARS

1992

Fitorja e zgjedhjeve parlamentare

TETOR

1992

Marrëveshja e tregtisë së lirë me BE

13 KORRIK

1995

Anëtarësimi në Këshillin e Europës

3 KORRIK

2005

Fitorja e zgjedhjeve të përgjithshme

QERSHOR

2006

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

10 QERSHOR

2007

Vizita e Presidentit Bush në Shqipëri

17 SHKURT

2008

Pavarësia e Kosovës

PRILL

2009

Anëtarësimi në NATO

DHJETOR

2010

Lëvizja e lirë në BE

1 GARANTIMI I LIRIVE TË HUMBURA

FAKT

Përqendrimi i ligjërimit publik rreth konceptit “ rrëzimi i komunizmit” ka ndikuar që ta bëj atë abstrakte për shqiptarët. Me kohën, është zbehur kujtesa. Gjatë regjimit komunist qytetarët shqiptarë nuk gëzonin as liritë më themelore të një qenie njerëzore, liri që sot merren të mirëqena duke harruar se kush i siguroi për Shqiptarët.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1 Shqiptarët mund të **shprehin lirisht mendimet** e tyre në rrethin e tyre privat apo në hapësirën publike. Ata mund të lavdërojnë apo kritikojnë këdo.
- 2 U shfuqizua ligji që shpallte Shqipërinë shtetin e vetëm ateist në botë. Çdokush **mund të ushtrojë në dritën e diellit fenë që dëshiron**, të ndjekë ritet apo të festojë ditët e shenjta të besimit të tij.
- 3 U zhbë detyrimi komunist për të jetuar dhe vdekur në vendin ku kishe lindur. Shqiptarët mund të **zgjedhin lirshëm vendbanimin** e tyre brenda Shqipërisë apo dhe të udhëtojnë jashtë.
- 4 Qytetarët **mund t’i japin jetë ëndrrave dhe ideve** të tyre duke krijuar ndërmarrje apo duke investuar në projekte të ndryshme.
- 5 **U garantua liria e medias**, shpesh në kundërshtim të hapur me qeverinë, ku qytetarët shqiptarë mund të zgjidhnin lirisht se ku dhe si dëshironin të informoheshin.

2

NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

FAKT

Partia Demokratike e gjeti Shqipërinë në vitin 1991 me institucione që shërbenin si instrument për kontrollin e individëve dhe mbajtjen e pushtetit me forcë. Sistemi i ri institucional u ndërtua mbi modele demokratike duke ndërthurur ndikime të ndryshme. Kjo ishte një zgjedhje e lirë dhe jo diçka e detyruar. Këtë e konfirmon edhe mungesa e vizionit institucional të qeverive socialiste që erdhën më pas.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1** U ngritën **institucionet demokratike përfaqësuese** si Kuvendi apo Presidenti i Republikës të cilat ekzistojnë në një formë tjetër me qëllim shtypjen e individëve.
- 2** U ndërtuan me shumë vështirësi për kohën **administratat ekonomiko/financiare pa të cilat shteti nuk mund të vepronte** si administrata tatimore, doganore, Instituti i Statistikave etj.
- 3** **U krijua i gjithë sistemi i ri i gjykatave**, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Shkolla Kombëtare e Magjistraturës, Gjykatat Administrative. Gjyqtarët nuk duhej më të ishin anëtarë partie.
- 4** **U vendos sistemi i profesioneve të lira** si garanci cilësie për qytetarët si Avokatia, Noteria, Përmbarimi, dentistët, kontabilistët.
- 5** U zbatua **koncepti i autoriteteve dhe agjencive të pavarura** mbikëqyrëse si Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Shkolla Kombëtare e Administratës, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

3

LEHTËSIMI I JETESËS SË PËRDITSHME

FAKT

Komunizmi e la Shqipërinë në “ sistemin e tollonava” e “ të radhëve të gjata të qumështit”. Aparatet mjekësore mungonin, infrastruktura rrugore ishte e dobët, energjia e kufizuar. Lëvizjet jashtë shtetit ishin të vështira ose të pamundura qoftë edhe për të shkuar pranë të afërmeve të sëmurë. Socialistët bënë shumë pak për ta lehtësuar jetën shqiptarëve duke u marrë më shumë me lyerje pallatesh se sa me reforma të qenësishme.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1 Raftet e ushqimeve nuk ishin më bosh.** Shqiptarët mund të zgjidhnin midis shumëllojshmërisë së produkteve dhe të ushqeheshin shëndetshëm.
- 2** U ndërtuan/ rindërtuan në të gjithë vendin **mbi 11 mijë km rrugë**, disa prej të cilave historike si Rruga e Kombit apo e Elbasanit duke mundësuar lehtësim në lëvizje.
- 3** U realizuan kartat e identitetit dhe pasaportat biometrike që hapën rrugën e liberalizimit të vizave dhe **lëvizjen e lirë të shqiptarëve** anembanë botës.
- 4 U ndërtuan 720 ujësjellësa**, 10 impiante të përpunimit të ujërave të zeza, 400 qendra shëndetësore dhe spitale, si dhe qindra km kanale vaditëse. Shumica e rrugëve dhe rrugicave u ndriçuan.
- 5** Solli për shoqërinë shqiptare mundësinë e zgjedhjes së kalimit të kohës së lirë (hobby) për të gjithë brezat sipas dëshirës dhe mundësive duke i dhënë përparësi lulëzimit të **individit si personalitet i çliruar nga dogmat ideologjike.**

4 FORCIMI I SOVRANITETIT TË VENDIT

FAKT

Qeverisjet komuniste dhe socialiste lanë Shqipërinë të brishtë përballë rreziqeve të jashtme, qofshin këto ushtarake (mungesa e një ushtrie funksionale apo e aleancave me shtete të rëndësishme, braktisja e çështjes së Kosovës), ushqimore (varësia ndaj produkteve të jashtme) apo edhe energjetike (6 deri në 10 orë në ditë furnizoheshin me gjenerator privatë, gjë që shkaktonte stres dhe kosto).

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1 U përforcua bashkëpunimi strategjik me aleatët e mëdhenj deri në **integrimin në NATO** që vulosi mbrojtjen e Shqipërisë ndaj rreziqeve ushtarake.
- 2 Shqipëria doli nga regjimi i gjeneratorëve dhe **hyri tek ai i energjisë së sigurt dhe të rinovueshme** nëpërmjet licencimit të mbi 400 hidrocentraleve.
- 3 U ngulën të gjitha piketat që shënojnë rrugën e **marrëdhënieve strategjike** të vendit tonë me Sh BA, që kulmuan me vizitën e Presidentit Bush apo Sekretarëve të Shtetit Bejker dhe Klinton.
- 4 80% e tregut të brendshëm u mbulua nga prodhimet bujqësore vendase dhe eksporti u rrit mbi 20 % falë politikave mbështetëse. **U mbollën miliona rrënjë ullinj**, mollë, arra, vreshta dhe dru të tjerë frutor.
- 5 Shqipëria shoqëroi dhe mbështeti **pavarësinë e Kosovës** duke siguruar ndërmjetësimin ndërkombëtar apo me parime që u njohën botërisht si “Pavarësia e kushtëzuar” dhe “Shqipëria nuk është aktore por është aktive”.

5

MBROJTJA E INDIVIDËVE

FAKT

Gjatë regjimit komunist dhe qeverisjeve socialiste, qytetarët shqiptarë kanë qenë të pambrojtur përballë shtetit, varfërisë apo bandave kriminale që kanë lulëzuar në vend. Policia ka qenë e diskredituar, punëtorët dhe personat në nevojë nuk kishin mbrojtje apo mbështetje nga shteti. Bandat lëviznin lirisht duke bërë fushatë haptazi në mbrojtje të socialistëve.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1** U vendos **mbrojtja sociale e personave në nevojë** nëpërmjet asistencës sociale dhe ndihmave të tjera si ajo për personat me aftësi të kufizuara.
- 2** U çor maska e Rilindjes në mënyrë të vazhdueshme duke nxjerrë në pah kriminelët në radhët e saj nëpërmjet **dekrimalizimit** dhe denoncimeve të skandaleve.
- 3** Shqipëria u fut në organizata si Frontex dhe Interpol. Gjithashtu **u ndaluan skafet** duke rritur kështu luftën e shtetit ndaj krimit në rrugë detare.
- 4** Në vitin 2005, në vetëm 18 muaj, **u vendosën para ligjit mbi 1000 shefa apo anëtarë, të 204 bandave kriminale** që operonin në vend duke shënuar kështu forcën e shtetit.
- 5** **Shqipëria u bë anëtare e Këshillit e Europës** dhe Gjykatës Europiane të Drejtave të Njëriut duke i dhënë një mbrojtje ndërkombëtare në shkallë të lartë qytetarëve shqiptarë ndaj shtetit.

6

BESIMI TE NDËRMARRJET PRIVATE

FAKT

Një prej pikave të përbashkëta midis komunistëve dhe socialistëve në qeveritë shqiptare është mungesa e besimit tek roli që ndërmarrjet private mund dhe duhet të luajnë në zhvillimit ekonomik, në inovacion etj. Si pasojë, komunistët i ndaluan, kurse socialistët e vështirësuan aktivitetin e tyre me pengesa administrative dhe barriera konkurruese. Burokracia e madhe detyronte shpesh ndërmarrjet të përballëshin me zyrat dhe nëpunësit e shtetit duke rritur ndjeshëm korrupsionin.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1** Krijimi i **One Stop Shop** për të reduktuar kohën dhe koston e regjistrimit të bizneseve, thjeshtëzimi i procedurave doganore dhe tatimore.
- 2** **U ul tatimi mbi fitimin**, mbi dividendin, sigurimet shoqërore, tarifatat doganore (nga 6% në 1%). U ulën dhe u hoqën 18 taksa të tjera kombëtare.
U reduktua koha e regjistrimit të biznesit nga 42 ditë në 30 minuta dhe
- 3** **kosto nga 4000€ në 1€**, u krijua Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- 4** U shfuqizuan brenda një dite 250 licenca dhe **u thjeshtëzua procedura** për 250 të tjera , u krijua Qendra Kombëtare e Licencimit.
- 5** U sanksionua në ligj nisma “1 euro” për dhënien me 1 euro të tokës publike për investitorët e huaj të mëdhenj të cilët paraqesin **projekte vizionare për Shqipërinë** dhe sjellin gjenerim të ardhurash, vende pune e një frymë të re në ekonominë shqiptare.

7

RRITJA E MIRËQENIES EKONOMIKE

FAKT

Regjimi komunist dënoi shqiptarët të jetonin duke punuar 6 ditë në 7, me vetëm 15 ditë leje në vit, pa gëzuar në kthim një mirëqenie materiale apo financiare. Pasuesit socialist nuk shtuan të drejta, ata rritën barrën fiskale dhe përqëndruan mirëqenien ekonomike brenda një grushti njerëzish.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1** **220 mijë familje u bënë pronare të shtëpive ku jetoni** dhe 460 mijë familje të fermave që punonin duke dhënë shpresën e një fillimi të ri në vend.
- 2** Java e punës shkoi në 5 ditë ose 40 orë, leja vjetore u zgjat në 4 javë. **U zgjat leja e lindjes për nënat e reja** që të kujdeseshin për foshnjat e sapolindura.
- 3** Liberalizimi i çmimeve i dha mundësinë e menjëhershme **çeljes së bizneseve të para**, eksporteve dhe importeve të produkteve të munguara në treg.
- 4** TVSH u vendos që në fillim 12,5%. **Barra fiskale u ul në 10% nëpërmjet taksës së sheshtë** duke liruar të ardhura për të kursyer, për të shpenzuar apo për të investuar.
- 5** U krijua sistemi i bankave me 2 shkallë. Banka e Shqipërisë për të sjellë **mbrojtjen e monedhës vendase** ndaj goditjeve të ndryshme dhe bankat e nivelit të dytë për të formalizuar paranë, transfertat, pagesat dhe për të ofruar siguri në kursime dhe mundësi për kredi e investim në ekonominë reale.

FAKT

Në vitin 2005, qytetarët shqiptarë dërgonin “zile” për të lajmëruar njëri tjetrin në telefon për shkak të çmimeve të larta të telefonisë celulare. Kishin pak ose aspak akses në internet dhe përballeshin me një administratë shumë larg standardeve që kërkonte dixhitalizimi i shpejtë i botës. Njëlloj siç shteti duhej ndërtuar nga zero në vitin 1992, Shqipëria dixhitale duhej menduar dhe realizuar nga zero në vitin 2005.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1 U ulën 3 deri në 5 herë çmimet** e bisedave me celular dhe me 7 herë çmimi i internetit nëpërmjet një politike të konkurrencës dhe thyerjes së monopoleve.
- 2 Përdorimi i internetit u shpall një prioritet** i rëndësishëm. U përhap në 63% të popullsisë në vitin 2012 nga 4, 8% që ishte në vitin 2006.
- U mendua dhe **u përgatitën inovacionet** e nevojshme duke shtrirë në mbarë vendin teknologjinë 3G dhe duke përgatitur kuadrin për 4G.
- U mundësua **shërbimi falas i internetit** në 1250 zyra në të gjithë vendin, ku 550 ishin në zyra postare që kishin edhe wireless falas deri në 5 metra.
- U krijua baza infrastrukturore** e telekomunikacionit dhe kompjuterizimit (rrjet, institucione, software etj.) mbi të cilën janë mbështetur të gjitha reformat e dixhitalizimit të shërbimeve administrative deri më sot.

9

HAPJA E ARSIMIT PËR TË GJITHË

FAKT

Gjatë komunizmit mund të ndiqje studimet vetëm nëse të jepte të drejtën Partia e Punës, gjatë qeverisjes socialiste ëndrra se çdo gjë mund të arrihet thyhej mbi muret dhe keqorganizimin e arsimit në vend. Shkollat ishin të vjetra, mësuesit e pakët dhe të keqpaguar, universitetet të paarritshme nga shumica dërmuese e qytetarëve shqiptarë.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1 U rrit numri i pedagogëve** nga 6000 në 10500 në mënyrë që të përshtatej me rritjen e popullsisë dhe nevojat e reja arsimore. Rrogat u rritën me 120- 140%.
- 2 U pajisën mbi 2800 shkolla me laboratorë kompjuterikë** të lidhur me internet (nga 33 përpara vitit 2005).
- 3 U ndërtuan ose u rindërtuan mbi 1360 shkolla dhe institucione arsimore duke rritur ndjeshëm kushtet e mësimdhënies.**
- 4 Shqipëria u fut në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë** (Procesi i Bolonjës) duke hapur horizontin ndërkombëtar për studentët shqiptarë (për të punuar apo për tu specializuar).
- 5 U krijua mundësia e vërtetë për çdo shqiptar që të shkollohet nëpërmjet parimit të konkursit. Kalimi në gjimnaz shkoi nga 68% në 86% (2005-2013) dhe 70% e maturantëve shkonin në universitete të cilat u hapën në çdo cep të vendit. Për herë të parë, rinia shqiptare kishte të ardhmen e saj në dorë.**

10 MBROJTJA E TRASHËGIMISË

FAKT

Komunistët dhe pasuesit e tyre socialistë bënë çdo gjë për të zhbërë identitetin dhe historinë e Shqipërisë në mënyrë që të kontrollonin më lehtë njerëzit nëpërmjet sistemeve propagandistike të forta. Pak e nga pak, fillimi të zhdukej identiteti i vërtetë shqiptar për të lënë vend narrativës fiktime. Qeveritë socialiste nuk nguruan asnjëherë të shkatërronin trashëgiminë për interesat e tyre, siç ka qenë rasti me rrënojat antike të Durrësit apo me Teatrin Kombëtar.

FALË PARTISË DEMOKRATIKE

- 1** Nën qeverisjen e Partisë Demokratike, asnjë pasuri e trashëgimisë kulturore nuk u shkatërrua dhe u punua për të siguruar përfshirjen dhe **mbrojtjen e tyre në UNESCO**.
- 2** **Butrinti u njoh në vitin 1992 nga UNESCO** si një pasuri botërore e njerëzimit.
- 3** Iso-polifonia popullore shqiptare u shpall si “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit” në nëntor të vitit 2005 dhe u njoh si Trashëgimi Shpirtërore (jo materiale) e Njerëzimit në vitin 2008.
- 4** **Berati u njoh nga UNESCO** si një pasuri botërore e njerëzimit në vitin 2008.
- 5** Në vitin 2008, u bënë ndryshime të rëndësishme në kufijtë e Qendrës Historike të Gjirokastrës. Gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike, u realizuan **investime per restaurimin e objekteve me vlera historike** si Pazari i Vjetër, rrugën e kalldrëmtë të Kalasë, hapjen e Qendres së Parë Turistike në vitin 2007 etj.

STATISTIKA

TË PËRZGJEDHURA

Vendosja e taksës së sheshtë 10% (ulja e tatimit nga 25% në 10%, ulja e tatimit të ardhurave personale nga 23% në 10%); Ulja e sigurimeve shoqërore nga 32% në 15% për punëdhënësin; Ulja e tarifave doganore nga 6% në 1%,

Në vitet 1992-1996 **liberalizimi i plotë i ekonomisë** më të hiperkolektivizuar dhe centralizuar në Europë bëri që 80% e prodhimit të brendshëm të vij nga sektori privat. Në vitet 2005-2013 numri i bizneseve u trefishua.

Eksporti u rrit mbi 300% kurse investimet e huaja u rritën përkatësisht me 316%.

Të ardhurat buxhetore u rritën mbi dyfishin e mëparshëm dhe kreditë për ekonominë u rritën 6 herë

Sipas Censurit të vitit 2011: **343 mijë familje shqiptare kishin më shumë se një shtëpi**. Raporti për 1000 banorë i pronësisë kalonte 5 shtete të vendeve anëtare të BE

Qeveria e PD dhe aleatëve të saj rriti me 120-150% rrogat dhe 100% pensionet e ulëta. Varfëria u ul nga 18,5 në 12,3% kurse varfëria ekstreme u ul nga 4,3 në 1,3%. Papunësia njohu ulje progresive deri në 12,8%

STATISTIKA

TË PËRZGJEDHURA

Në vitet 2006-2013 u ndërtuan dhe rindërtuan në mbarë vendin mbi 11 mijë km rrugë kombëtare dhe në qytete, pra siç thotë Komisioni Europian më shumë se në të gjithë rajonin. Në këto vite u ndërtuan: Rruga e Kombit, autostrada Tiranë-Elbasan në të cilën vetëm tunele janë 16 km, autostradat Lushnjë-Fier, Levan-Vlorë, Thumanë-Milot, superstradat Levan-Tepelenë- Gjirokastër, Shkodër-Han i Hotit etj.

Në vitet 2006 - 2013 u ndërtuan apo rindërtuan: 1300 shkolla e institucione arsimore, 720 sisteme ujësjellësish dhe kanalizimesh, 10 impiante të përpunimit të ujërave të zeza dhe 400 qendra shëndetësore dhe spitale

U ndërtua terminali i Aeroportit të Rinasit dhe më pas në fazën e dytë u dyfishua ky terminal.

Rindërtim dhe rikonceptimi i Portit të Durrësit, derës kryesore të Shqipërisë drejt Europës. U zgjeruan ndjeshëm portet e Sarandës, Vlorës dhe Shëngjinit

Borxhi u rrit nga 58. 2% ne 62. 6% e Produktit të Brendshëm Bruto nga 2005-2013, ndërsa në 2023 ka kaluar 107% e PBB. Në këto 8 vite qeverisje të PD **niveli i investimeve ishte më i madh sesa borxhi** i marrë

STATISTIKA

TË PËRZGJEDHURA

Shqipëria superfuqi e vogël e energjisë së rinovueshme në rajon u bë moto e qeverisë së PD dhe aleatëve të saj. **Shqipëria u bë vendi i dy projekte gjigande energjetike:** TAP, investimi aktual më i madh në Europë, gazsjellësi që do sjellë gazin azer në Itali, kaskada e Devollit, investimi më i madh hidroenergjetik në Shqipëri dhe Kaskada e Fanit.

Qeveria firmosi ndërtimin e 432 hidrocentraleve me koncesion nga kompanitë private, nga të cilat 128 kanë përfunduar dhe japin mbi 50% të prodhimit të energjisë së vendit dhe 89 janë në ndërtim e sipër.

Në Shqipërinë rurale në 8 vite u investuan 3.2 miliardë euro.

U ndërtuan 8300 km rrugë rajonale, dytësore dhe të treta. U subvencionuan 45 mijë projekte në bujqësi e blegtori, gjë që bëri të mundur të mbillen mbi 7 milionë rrënjë ullinj në mbarë vendin dhe miliona rrënje mollë, arra, vreshta dhe dru të tjerë frutor.

Numri i turistëve dhe vizitorëve nga 300 mijë që ishte në vitin 2004 **u rrit në 4,7 milion në vitin 2012.**

Shqipëria e cila në vitin 1992 ishte një nga vendet më të varfra të planetit arriti **në vitin 2008 të futet te grupi i vendeve me të ardhura të mesme të larta.**

U zbatua ligji për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik në regjimin komunist dhe me 12. 11. 2007 filluan pagesat e para dëmshpërblyese.

PASQYRA

Frymëzimi	F. 2
Metodologjia	F. 3
Shënim për lexuesin	F. 4
Data kyçe	F. 5
Garantimi i lirive të humbura	F. 6
Ndërtimi i institucioneve demokratike	F. 7
Lehtësimi i jetesës së përditshme	F. 8
Forcimi i sovranitetit të vendit	F. 9
Mbrojtja e individëve	F. 10
Besimi te ndërmarrjet private	F. 11
Rritja e mirëqenies ekonomike	F. 12
Rruga drejt dixhitalizimit	F. 13
Hapja e arsimit për të gjithë	F. 14
Mbrojtja e trashëgimisë	F. 15
Statistika të përzgjedhura	F. 16

Ky dokument është më shumë se një bilanc,
është një premtim.

Premtimi i një grupi të rinjsh, të një departamenti
të ri brenda një partie të rithemeluar.

Premtimi se Lidhja midis Brezave do shoqërojë
në çdo hap veprimtarinë tonë.

Premtimi se beteja e kujtesës nuk do anashkalohej asnjëherë.
Premtimi se krenaria e të qënurit demokrat do rikthehet tek
një gjeneratë që vazhdon të ëndërrojë.

Ky dokument është një premtim,
Ky dokument është një shpresë.

*Amanda Zeqiri
Andi Mustafaj
Aurora Barçi
Gerti Toku
Gledis Muhametaj
Ted Kopluku*



**Partia
Demokratike**

